



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 3, Datë 07/01/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 115, datë 03.08.2018, e Znj. D.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes filozofike<sup>1</sup>” dhe “gjinisë”, nga ana e Z. M.K., Rektor i Universitetit të Tiranës dhe Znj. D.P., Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë Rektoratit të UT .

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Znj. D.K. punon pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës që prej vitit 2010. Së fundmi, ankuesja ka punuar në pozicionin e specialistes në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe IT. Në ankesën e saj, Znj.

---

<sup>1</sup>Në fillim të shqyrtimit të ankesës, Znj. D.K. e ndryshoi shkakun e diskriminimit të pretenduar, nga “*bindjet filozofike*” në formën e diskriminimit për shkak të shoqërimit me Znj. A. B. Nëpërmjet Vendimit nr. 145, datë 02.07.2018, KMD ka konstatuar diskriminimin për shkak të “gjinisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, të Znj. A.B., nga ana e Z. M.K., Rektor i Universitetit të Tiranës. Në këtë kontekst, duke qënë se “shoqërimi” është një formë e diskriminimit, ankuesja D.K. mbart shkaqet e diskriminimit të Znj. A.B, që janë - *gjinia dhe përkatësia në një grup të veçantë*.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

D.K. përmend disa momente diskriminuese, duke filluar nga viti 2016<sup>3</sup> e në vijim. Situata e parë diskriminuese e përmendur nga ankuesja, lidhet me ankesat e saj për shkak të bllokimit të pagave për punonjësit e Rektoratit, gjatë muajve gusht-shtator 2017. Ankuesja ka drejtuar disa kërkesa, ku është shprehur shqetësimi i saj për mosdhënien e pagave përgjatë kësaj periudhe. Në vijim të këtij momenti, me shkresën nr. 436, datë 29.01.2018, të Rektorit të UT, ankueses i është kërkuar të dalë nga zyra, ku ajo aktualisht punonte, në mënyrë që kjo zyrë t'i kalonte Z. E. S., Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit, në Rektoratin e UT-së, i cili është paraqitur me shkresën e sipërpërmendur dhe i ka kërkuar ankueses të largohet nga zyra e saj. Znj. D.K. pretendon se janë kryer 3 (tre) takime në zyrën e Administratorit, lidhur me këtë çështje, ku Z. E. S. ka shprehur insistim për marrjen e zyrës së ankueses. Znj. D.K. shprehet se i është drejtuar zyrtarisht Rektorit të UT, lidhur me sa më sipër, duke shprehur shqetësimin e saj mbi situatën në fjalë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Momenti tjetër diskriminues i pretenduar nga ana e ankueses ka ndodhur në muajin mars 2018, kur ajo ka marrë informacion mbi përllogaritjen e gabuar të vjetërsisë së saj në punë, për efekt të shtesës në pagë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të Rektoratit të UT-së. Znj. D.K. shprehet se është interesuar fillimisht pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, pranë Rektoratit të UT-së, lidhur me këtë çështje, ku dhe është informuar mbi faktin se të dhënat mbi vjetërsinë në punë përllogariteshin nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, strukturat përgjegjëse të së cilës kishin përcjellë informacion të pasaktë. Në vijim të një korrespondence zyrtare ndërmjet Rektorit të UT-së dhe Znj. D.K., rezulton se në referencë të shkresës nr. 3057/1, datë 25.06.2018, së Rektorit të UT-së, përllogaritja e vjetërsisë në punë për Znj. Karaj, ka qenë gabim njerëzor dhe se ky ndryshim do të reflektohej në llogaritjen e pagës së saj mujore.

Në vijim me shkresën nr. 3477/2, datë 26.07.2018, ankuesja njoftohet se duhet të paraqitet në datën 30.07.2018, në zyrat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për të diskutuar në lidhje me kontratën e saj të punës. Gjatë takimit në datën e sipërpërmendur, ankuesja bëhet me dije se është ngritur një grup pune për të audituar punën e saj ndër vite, fakt për të cilin Znj. D.K. nuk ka patur dijeni. Në pritje për t'u njohur me raportin e grupit auditues të punës, ankuesja informohet mbi Vendimin nr. 119, datë 02.08.2018, të Rektorit të UT-së, lidhur me zgjidhjen e kontratës së saj të punës, në mënyrë të menjëherëshme, për shkaqe të justifikuar. Znj. D.K. shprehet se prej 8 (tetë) vitesh që punon pranë Rektoratit të UT-së, ndaj saj nuk është dhënë asnjë masë disiplinore apo qoftë edhe tërheqje vëmendjeje në mënyrë verbale. Ankuesja shprehet se gjatë gjithë kohës që ka punuar pranë Rektoratit të UT-së ka zbatuar urdhërat e epërëve të saj dhe ka vepruar

---

<sup>3</sup> Ankuesja u informua nga strukturat përkatëse të KMD-së se situatat diskriminuese të pretenduara nga ana e saj, të cilat i përkasin vitit 2016, mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 4, gërma dh) nuk mund të pranohen për shqyrtim dhe si të tilla nuk u morën në shqyrtim nga KMD.

konform tyre. Ankuesja shprehet se ndaj saj ka patur reagime të tilla nga ana e Rektorit dhe Drejtores së Burimeve Njerëzore, pasi ajo shoqërohet me Znj. A. B., e cila ka rezultuar e diskriminuar nga ana e Rektorit të UT, diskriminim ky i konstatuar në vendimin nr. 145, datë 02.07.2018, e Komisionerit, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe për shkak të gjinisë. Një fakt i tillë mbështetet nga Znj. Bregu, e cila nëpërmjet shkresës së datës 13.08.2018, mbështet pretendimet e Znj. D.K.. Njëkohësisht, Znj. D.K. pretendon se ajo është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues edhe për shkak të gjinisë.

### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Fillimisht, strukturat përkatëse të Komisionerit kontaktuan me e-mail me ankuesen, duke i kërkuar të dhëna të mëtejshme, lidhur me ankesën e depozituar pranë KMD-së. Ankuesja e dërgoi informacionin e kërkuar me e-mail në adresë të Komisionerit.
  
- B.** Në vijim të dërgimit të informacionit plotësues nga Znj. D.K., Znj. A. B., Znj. E. Q.-C. dhe Znj. I. B. –Sh. dërguan pranë Komisionerit e-mail-in, e datës 13.08.2018, nëpërmjet së cilit, informonin mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja D.K.. Sipas letrës në fjalë rezulton se personat në fjalë, veç marrëdhënieve miqësore brenda ambienteve të punës, kanë marrëdhënie miqësore edhe jashtë orarit zyrtar me ankuesen. Sipas e-mailit në fjalë, Znj. D.K. ka përballuar e vetme një punë shumë voluminoze në Zyrën e Kërkimit Shkencor për 6 vite, pa patur asnjë ndihmë dhe asnjë mbështetje, ku ka trajtuar të gjitha dosjet për titujt akademikë në vitet 2012-2018 e të gjithë praktikantët për doktoraturat për të gjithë fakultetet e UT. Nga viti 2016 e në vijim, ankuesja, por jo vetëm ajo, ka patur shqetësime dhe pakënaqësi nga titullari i institucionit duke filluar me mohimin e lejes vjetore të miratuar nga titullari i mëparshëm për një javë në muajin korrik 2016. Në vazhdim, për efekt të bllokimit të pagave të punonjësve të Rektoratit, në grup me Znj. D.K. është insistuar dhe kërkuar të zgjidhej çështja e pagave, e cila kapi kulmin e saj në periudhën gusht-shtator 2017. Në vijim të këtij insistimi, u penalizua A. B., e cila pushua nga puna në mënyrë të menjëherëshme, pa shkelje të konstatuara. Edhe Znj. E. Q., aktualisht Kancelare e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është ndërrshkuar me dy masa disiplinore nga Rektori në vitin 2017, pasi nuk ka pranuar të ekzekutojë urdhërat dhe kontratat administrative të prokurimeve publike, të lidhura nga Rektori, pasi këto nuk janë në kompetencën e tij, por të Administratorit të UT. Znj. I. B., punonjëse me kontratë pune, mbi organike, është penalizuar nga Rektori duke mos i rinovuar kontrata e punës, për faktin se ka bashkëpunuar dhe ka marrë urdhëra nga Administratori dhe se ka hartuar listëprezencat në punë sipas dispozitave ligjore. Znj. D.K.,

nën vazhdën e shqetësimeve të shkaktuara në detyrë, ka patur të tilla, në mënyrë të vazhdueshme nga Z. E. S., me detyrë Drejtor i Komunikimit, i cili e pengonte në punë duke i kërkuar t'i lironte zyrën e të gjente zyrë tjetër. Ndër të tjera, në shkresë theksohet fakti se jo vetëm Daniela, por edhe punonjëse të tjera janë shqetësuar dhe bezdisur në mënyrë të vazhdueshme nga ish-sekretarja e Rektorit, aktualisht Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet talljeve, fyerjeve e shpifjeve nëpër korridoret e Rektoratit. Këta persona kanë vepruar nën hijen dhe mbrojtjen e Rektorit, i cili ka sjellë përçarje, diskriminim, veçim dhe shqetësim të punonjësve të etiketuar si të ish-Rektorit.

C. Pas analizimit të ankesës nr. 115, datë 03.08.2018, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

D. Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1096/2, datë 15.08.2018, Z. M.K., Rektor i Universitetit të Tiranës dhe Znj. D.P., Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë Rektoratit të UT, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja, si dhe iu kërkuua të dërgoheshin aktet e poshtëcituarat:

- Kopje të kërkesave të Znj. D.K., drejtuar Rektorit të UT-së, që kanë si objekt të tyre mosdhënien e pagave përgjatë muajve gusht-shtator 2017.
- Informacion mbi çështjen e lëvizjes nga zyra të Znj. D.K.. Korrespondenca zyrtare ndërmjet ankueses dhe Rektorit të UT;
- Informacion mbi çështjen e llogaritjes së gabuar të vjetërsisë në punë të Znj. D.K., si dhe kopje e korrespondencës zyrtare me ankuesen;
- Informacion mbi çështjen e auditimit të punës së Znj. D.K., ku të evidentohen qartë:
  - Nëse ankuesja ishte njohur paraprakisht me urdhërin e Rektorit për auditim të punës së saj ndër vite. Të dërgohet pranë KMD-së një kopje e Urdhërit të sipërpërmendur, një kopje e Raportit të Auditit, si dhe kopje e faqes së regjistrit, ku vërtetohet me nënshkrim të ankueses, se ajo ka marrë dijeni mbi këtë urdhër.

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- A janë gjetur shkelje/gabime gjatë punës së kryer nga ankuesja? Nëse po, cili është qendrimi i Rektorit ndaj eprorëve të Znj. D.K., të cilët kanë miratuar, nënshkruar shkresat e konceptuara nga ajo dhe kanë dhënë urdhërat përkatës, në zbatim të së cilave ka vepruar ankuesja?
  - A ka garantuar Rektori në cilësinë e punëdhënësit, të drejtën e punëmarrësit për t'u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm, lidhur me masën për largim nga puna?
  - Të dërgohet Vendimi i Rektorit, nëpërmjet së cilit Znj. D.K. është larguar nga puna;
    - Kopje të kontratave të punës së ankueses me Rektorin e UT-së.
    - Kopje e librezës së punës së ankueses;
    - Informacion nëse ankuesja është ndërkohë me masa disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Rektoratit të UT-së. Nëse po të përcillen pranë KMD-së, kopje të masave disiplinore të dhëna ndaj saj.
    - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja, ndër vite pranë Rektoratit të UT-së.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1096/2, datë 15.08.2018, të Komisionerit, Rektori i UT-së dërgoi shkresën nr. 1096/4, datë 14.09.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije KMD, se në referencë të pretendimeve të ankueses mbi situatën e parë diskriminuese, që lidhet me ankesat e saj, për shkak të bllokimit të pagave për punonjësit e Rektoratit gjatë muajve gusht-shtator 2017, në protokollin e institucionit nuk rezultojnë të jetë regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë e ankueses, në lidhje me këtë çështje. Si rrjedhim, në shkresën e Rektorit theksohet se ky fakt i pretenduar nga ankuesja është tërësisht i pavërtetë.

Lidhur me shkresën nr 436, datë 29.01.2018, të Rektorit, për të cilën ankuesja pretendon se i është kërkuar të largohet nga zyra e saj, në shkresën e Rektorit sqarohet fakti se zyrat dhe ambientet ku punonjësit e Rektoratit ushtrojnë detyrën, janë të institucionit dhe jo personale. Shkresa e sipërpërmendur nuk i është drejtuar vetëm ankueses, por edhe Z. E. S., Drejtor i Komunikimit. Kjo shkresë u është drejtuar punonjësve në fjalë me qëllimin e vetëm, atë të mbarëvajtjes në punë të strukturave, ku bënin pjesë. Konkretisht, nëpërmjet kësaj shkrese, Z. Skëndaj i është kërkuar të zhvendoset tek zyra në fund të korridorit (ku qendronte ankuesja) dhe Znj. D.K., specialiste pranë Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve i është kërkuar të zhvendosej tek Zyra e Drejtorisë së Kurrikulave. Kjo është bërë, për shkak se në zyrën që ka mbajtur ankuesja kanë punuar dhe punojnë 3 punonjës të Drejtorisë së Komunikimit, me varësi direkte funksionale nga Z. E.S. Ndërsa ankuesja ka qenë punonjësja e vetme e Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe nuk ka patur lidhje pune me punonjësit e tjerë të zyrës ku punonte. Sipas nevojave që lindin në institucion, vazhdimisht bëhen lëvizje të punonjësve nga një zyrë në tjetrën. Megjithatë duke vërejtur shqetësimin e Znj. D.K. në lidhje me këtë fakt, nuk i është kërkuar më tej zhvendosja në zyrën e caktuar.

Në lidhje me çështjen e përllogaritjes së gabuar të vjetërsisë në punë të Znj. D.K., Rektori e bën me dije Komisionerin se menjëherë pas paraqitjes pranë Rektorit të UT-së, të kërkesës së ankueses D.K., datë 19.06.2018, lidhur me llogaritjen e viteve të punës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore kreu verifikimet përkatëse, nga ku rezultoi se përllogaritja e viteve të punës së ankueses ishte gabim njerëzor i mbartur qysh prej fillimit të marrëdhënieve të saj të punës në Rektorat. Në vijim, pas konstatimit të faktit, me shkresën nr.3057/1, datë 25.06.2018, ndryshimi përkatës iu përcoll për ekzekutim Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (Sektorit të Financës) për të pasqyruar ndryshimin e viteve të punës në përllogaritjen e pagës mujore të ankueses.

Lidhur me çështjen e zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëherëshme për ankuesen D.K., Rektori sqaron se me shkresën nr. 902, datë 30.05.2018, e Fakultetit të Ekonomisë “*Mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturë, kuotat e rialokuara*”, Fakulteti Ekonomik informon Rektoratin se nuk i ishin dërguar ende numrat e matrikullimeve për studentët e doktoraturës - kuotat e rialokuara, sipas të dhënave dhe kërkesës së dërguar me shkresën nr. 116, datë 30.01.2017, me të njëjtën lëndë të këtij Fakulteti. Pas verifikimit të kryer në zyrën e protokollit për të lidhur këto dy praktika shkresore, nëpërmjet memos së datës 11.06.2018, të Përgjegjëses së Sektorit të Protokoll Arkivës rezultoi se praktika – shkresë e Fakultetit të Ekonomisë nr. 116, datë 30.01.2017 nuk ishte dorëzuar nga Znj. D.K. dhe se kjo e fundit e kishte dorëzuar këtë shkresë vetëm në datën 03.06.2018, dmth pas mbërritjes së shkresës nr. 902, datë 30.05.2018, të Fakultetit të Ekonomisë. Pas njohjes me këtë fakt dhe me këtë problematikë, që kishte ardhur si pasojë e mbajtjes për një vit e gjysëm pa veprim, të kësaj praktike nga ana e ankueses, me shkresën nr. 2733/1, datë 19.06.2018, të Rektorit, ankuesja është njoftuar që të paraqitej në datën 20.06.2018, ora 13:00, pranë Zyrës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektorat, me qëllim dhënien e sqarimeve në lidhje me praktikat shkresore të lartpërmendura. Ankuesja është paraqitur në takim dhe sikurse është pasqyruar në procesverbalin përkatës, ankuesja ka kërkuar që shpjegimet në lidhje me këtë çështje t’i paraqesë me shkrim tek titullari. Në datën 20.06.2018, nga ana e ankueses është paraqitur informacioni me shkrim, ku bashkëlidhur gjendeshin 4 (katër) memo të hartuara nga ana e saj në periudha të ndryshme kohore, shkresa nr. 1454, datë 26.10.2016 e Fakultetit të Ekonomisë dhe një fletë me përllogaritje të kryera nga ana e saj. Për sa më sipër, nisur nga problematika e paraqitur nga Fakulteti i Ekonomisë, me shkresën nr. 902, datë 30.05.2018, si dhe pas marrjes së informacionit me shkrim dhe të dokumenteve justifikuese, nga ana e Zj. D.K., me qëllim verifikimin e saktë të pretendimeve të saj, Rektori nëpërmjet Urdhërit nr. 10, datë 16.07.2018, urdhëroi ngritjen e grupit të punës për të kryer verifikimet përkatëse.

Pas kryerjes së verifikimeve rezultoi se :

**Së pari**, Znj. D.K. nuk kishte përcjellë në Fakultetin e Ekonomisë dhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, numrat e matrikullimit të ardhura me shkresën nr 887, datë 06.05.2018, nga AKP për studentët doktorantë të regjistruar në vitin akademik 2011-2012.

**Së dyti**, në mënyrë të vazhdueshme ankuesja i kishte dhënë Rektorit informacion jo të saktë në lidhje me pajisjen me numra matrikullimi të studentëve doktorantë të Fakultetit të Ekonomisë të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 (memot e saj). Pra, informonte vazhdimisht me memot e saj të vitit 2016 dhe 2017, se numrat e matrikullimit nuk kishin ardhur në UT nga AKP, ndërkohë që këto numra kishin ardhur me shkresën nr. 887, datë 06.05.2015 nga AKP.

**Së treti**, përgjatë kësaj periudhe, ankuesja kishte plotësuar diploma doktrature vetëm me numër regjistri, ndërkohë që nga AKP ishin përcjellë më parë numrat e matrikullimit për studentët përkatës;

**Së katërti**, ankuesja kishte plotësuar diploma doktrature me numër regjistri (të cilat janë shpërndarë) edhe në rastet kur AKP nuk i kishte pajisur studentët me numër matrikullimi, për shkak se kishte konstatuar problematika në dokumentacionin e paraqitur prej tyre, siç ishte rasti i studentes doktorante A.G.

Në shkresën e Rektorit theksohet fakti se të gjitha sa më sipër rezultojnë nga fakte dhe prova të pakontestueshme, të ndodhura në arkivën e Rektoratit dhe që janë pasqyruar në mënyrë shumë të detajuar në Relacionin e mbajtur nga grupi i punës, në datën 20.07.2018. Pas konstatimit të shkeljeve shumë të rënda, të kryera nga ana e ankueses, ndaj saj është filluar procedura për largim nga puna, duke e njoftuar për takim me shkresën nr. 3477/2, datë 26.07.2018. Takimi është mbajtur në datën dhe orën e caktuar, përkatësisht në datën 30.07.2018, ora 10:00, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ku Znj. D.K. iu parashtruan arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë. Në vijim të këtij takimi është marrë Vendimi nr. 119, datë 02.08.2018, "Për zgjidhjen e menjëherëshme për shkaqe të justifikuar të kontratës së punës së Znj. D.K.", i cili i është njoftuar ankueses me shkresën nr. 3477/4, datë 02.08.2018. Sipas këtij vendimi, Znj. D.K. duhet t'i bënte dorëzimet e dokumentacionit që kishte në ngarkim, eprorit të saj të drejtpërdrejtë, Përgjegjësit të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, si dhe bazën materiale në magazinën e institucionit, deri në datën 09.08.2018.

Për sa më sipër, në shkresën e Rektorit sqarohet se me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 26.03.2018, e Senatit Akademik, struktura ku punonte ankuesja ka ndryshuar emërtim, nga Zyra

e Kërkimit Shkencor në varësi direkte të Zv/Rektorit për anën shkencore, në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, me epror direkt Përgjegjës në këtë zyre.

Sipas informacionit të përcjellë nga Përgjegjësi i kësaj zyre dhe Përgjegjësjë e Sektorit të Arkivë-Protokollit rezultojnë se ankuesja nuk i ka kryer dorëzimet dhe për këtë arsye është njoftuar përsëri me shkresën nr. 3477/9, datë 30.08.2018, e Rektorit, që deri në datën 06.09.2018 duhet të kryejë dorëzimet përkatëse. Por, pavarësisht sa më sipër, ajo nuk i ka kryer dorëzimet, në kundërshtim të hapur me çdo normë ligjore në fuqi dhe vazhdon të qëndrojë në zyrën që ka mbajtur, duke u bërë pengesë në vijueshmërinë e punës.

Rektori e bën me dije KMD se arsyeja e vetme e largimit të ankueses nga puna kanë qenë shkeljet e rënda që ajo ka kryer dhe pasojat e rënda që i ka sjellë këtij institucioni, në lidhje me rastet flagrante të konstatuara.

Ndër të tjera, Rektori sqaron se nuk ka patur Urdhër të Rektorit për auditim të punës së ankueses ndër vite. Nga ana e tij është ngritur një grup pune për të verifikuar informacionin e dhënë me shkrim nga ankuesja, lidhur me çështjen e parashtruar nga Fakulteti Ekonomik. Në shkresë theksohet fakti se ankuesja ka marrë dijeni lidhur me këtë problematikë me shkresën nr. 2733/1, datë 19.06.2018, e Rektorit, provuar me procesverbalin e datës 20.06.2018, të nënshkruar nga ankuesja.

Lidhur me qëndrimin e mbajtur ndaj eprorëve të Zj. D.K., Rektori sqaron se deri në datën 01.05.2018, kur është miratuar struktura e re e Rektoratit, ankuesja ka patur varësi direkte nga Zv/Rektori për anën shkencore. Për periudhën që është shfaqur problematika, Znj. D.K. ka patur varësi direkte nga Zv/Rektori, Z. Sh. R. Sipas dokumentacionit në arkivë, të pasqyruar edhe në Relacionin përkatës, ankueses i janë përcjellë për veprim shkresat, për të cilat është shfaqur problematika dhe ajo nuk ka vepruar. Pra, rezultojnë se Znj. D.K. ka hartuar shkresat përcjellëse për 4 nga fakultetet e UT-së dhe nuk ka hartuar shkresën përcjellëse për Fakultetin e Ekonomisë, nga i cili është shfaqur problematika. Gjithashtu, vihet re nga praktika se ankuesja i ka dhënë informacion jo të saktë Rektorit me memot e saj, duke përsëritur se numrat e matrikullimit nuk ishin dërguar nga AKP, ndërkohë që ato ishin dërguar nga AKP, me shkresën nr. 887, datë 06.05.2015, me lëndë “*Mbi dhënien e matrikullimit*”, në formatin elektronik CD.

Për sa më sipër, në shkresën e dërguar nga Rektori theksohet fakti se ankueses i është garantuar e drejta për t’u dëgjuar, si në rastin kur është shfaqur problematika (me shkresën nr. 2733/1, datë 19.06.2018, të Rektorit, e provuar me procesverbalin e datës 20.06.2018, të nënshkruar nga ankuesja), ashtu edhe në rastin e fillimit të procedurës së largimit nga puna për shkelje shumë të rënda dhe flagrante në kryerjen e detyrës (shkresa nr. 3477/2, datë 26.07.2018 dhe procesverbali datë 30.07.2018).



Ndër të tjera, Rektori e bën me dije KMD-në se ankuesja nuk ka patur asnjëherë masa disiplinore, si dhe nuk është ndjekur praktika e vlerësimeve të punës për punonjësit.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 1096/2, datë 15.08.2018, të Komisionerit, Znj. D.P., Drejtore e Burimeve Njerëzore pranë Rektoratit të UT-së dërgoi shkresën nr. 1096/1, datë 14.09.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije KMD-në, fillimisht në lidhje me çështjen e përlllogaritjes së gabuar të vjetërsisë në punë të Znj. D.K.. Sipas shkresës në fjalë, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës së datës 19.06.2018, së Znj. D.K., lidhur me llogaritjen e viteve të punës, Drejtorja e Burimeve Njerëzore kreu verifikimet përkatëse nga ku rezultoi se përlllogaritja e viteve të punës së ankueses ishte gabim njerëzor i mbartur qysh prej fillimit të marrëdhënieve të saj të punës në Rektorat. Në vijim, pas konstatimit të faktit, me shkresën nr.3057/1, datë 25.06.2018, e Rektorit, ndryshimi përkatës iu përcoll për ekzekutim Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (Sektorit të Financës), për të pasqyruar ndryshimin e viteve të punës në përlllogaritjen e pagës mujore të ankueses.

Znj. Panariti shprehet se është vepruar menjëherë pas depozitimit të kërkesës së ankueses, duke i sqaruar se përlllogaritja e gabuar e vjetërsisë në punë ishte një gabim njerëzor nga ana e punonjësve të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Në vijim, ankuesja është paguar për diferencën në pagë, për të gjithë periudhën në fjalë. Znj. Panariti kërkoi të dispononte një kopje të letrës së Znj. A. B., me anë të së cilës ajo mbështeste pretendimet e Znj. D.K..

3. Nëpërmjet shkresës nr. 1426, datë 17.10.2018, Komisioneri dërgoi në adresë të Znj. D.P., kopje të aktit të kërkuar nga ana e saj.

E. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, me anë të shkresës nr. 1096/5, datë 15.10.2018. Seanca dëgjimore u vendos të realizohej në datën 18.10.2018, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore u paraqitën të tre palët, përkatësisht ankuesja D.K., Znj. N. M., përfaqësuese me autorizim e Rektorit të Universitetit të Tiranës dhe Znj. D.P., Drejtore e Burimeve Njerëzore pranë Rektoratit të UT-së.

Në seancë dëgjimore ankuesja D.K. parashtroi edhe një herë pretendimet e saj, lidhur me çështjen në shqyrtim. Ankuesja tërhoqi pretendimet e saj ndaj Znj. D.P., duke e konsideruar të zgjidhur çështjen e përlllogaritjes gabim të vjetërsisë së saj në punë. E njëjta gjë vlen edhe për çështjen e lirimit të zyrës nga ana e ankueses, pasi gjatë seancës dëgjimore rezultoi se ankuesja punon ende në të njëjtën zyrë. Ndërkohë që, në lidhje me pretendimet për Rektorin e UT, ankuesja u shpreh se ka zbatuar të gjitha

urdhërat e dhëna nga Rektori dhe Zv/Rektori, në lidhje me punën e saj dhe e konsideron diskriminues veprimin e Rektorit për zgjidhjen e kontratën e punës. Përfaqësuesja e Rektorit të UT u shpreh se ankuesja ishte kryer shkelje të rënda në detyrë dhe ishte ky shkaku për zgjidhjen e kontratës së punës me Rektoratin e UT-së. Znj. N.M. theksoi faktin se fillesa e çështjes në fjalë ishte shkresa nr. 902, datë 30.05.2018, e Fakultetit të Ekonomisë “*Mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturë, kuotat e rialokuara*”, nëpërmjet së cilës Fakulteti Ekonomik informon Rektoratin se nuk i ishin dërguar ende numrat e matrikullimeve për studentët e doktoraturës - kuotat e rialokuara, sipas të dhënave dhe kërkesës së dërguar me shkresën nr. 116, datë 30.01.2017, me të njëjtën lëndë, të këtij Fakulteti. Në vijim Rektori i UT ka kërkuar informacion lidhur me çështjen e parashtruar nga ky fakultet. Nga arkiva e UT rezultoi se praktika lidhur me këtë çështje i ishte dorëzuar Znj. D.K.. Duke qënë se praktika paraardhëse kishte 1 vit e gjysëm që ishte depozituar pranë Rektoratit të UT-së dhe ishte lënë pa trajtuar, Rektori i UT e ka njoftuar shkresërisht ankuesen, për takim, për të sqaruar situatën konkrete. Znj. D.K. ka kërkuar që informacionin e saj ta dorëzojë me shkrim pranë Rektorit dhe ky i fundit ka rënë dakord me kërkesën e saj. Për të sqaruar çështjen në fjalë, Rektori i UT ngriti një grup pune për të kryer verifikimet përkatëse mbi praktikën e siç përpërmendur të Fakultetit Ekonomik. Pas kryerjes së verifikimeve, grupi i punës hartoi raportin përkatës nga ku rezultoi se Znj. D.K. kishte kryer një sërë shkeljesh. Në vijim ka dalë Vendimi nr. 119, datë 02.08.2018, i Rektorit të UT “*Për zgjidhjen e menjëherëshme për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës së Znj. D.K.*”, i cili i është njoftuar ankueses me shkresën nr. 3477/4, datë 02.08.2018.

Në seancë rezultoi se praktika e Fakultetit Ekonomik është dorëzuar në datën 03.06.2018 nga ankuesja. Bashkëlidhur praktikës ndodheshin edhe 4 (katër) Memo të ankueses, nëpërmjet së cilave ajo e informonte Rektorin, lidhur me numrin e matrikullimeve të doktoraturave pranë Fakultetit Ekonomik. Përfaqësuesja e Rektorit të UT-së dhe Znj. D.P., Drejtore e Burimeve Njerëzore pranë UT u shprehën se numrat e matrikullimit për studentët e Fakultetit Ekonomik ishin dërguar nëpërmjet shkresës nr. 887, datë 06.05.2015, të AKP-së, me lëndë “*Mbi dhënien e matrikullimit*”, në formatin elektronik CD. Znj. D.K. u shpreh se nuk kishte dijeni mbi përmbajtjen e CD, por kishte dijeni vetëm mbi përmbajtjen e shkresës.

Përfaqësuesja e Rektorit theksoi faktin se si pasojë e mbajtjes pezull të praktikës së këtij fakulteti nga ana e ankueses janë pajisur me diploma doktore, studentë, të cilët nuk kishin plotësuar ende dokumentacionin e kërkuar nga AKP. Znj. N. M. u shpreh se Znj. D.K. e ka njoftuar gabim Rektorin nëpërmjet memove të saj, duke u shprehur se numrat e matrikullimit nuk kishin ardhur ende, ndërkohë që kishte ndodhur e kundërta. Si pasojë e mbajtjes pezull të kësaj praktike, 6 studentë të doktoraturës nuk janë pajisur me kartonat përkatës.

E pyetur nga ana e KMD-së, se pavarësisht shkeljeve të konstatuara, përse ishte marrë masë disiplinore për zgjidhjen e kontratës së punës për Znj. D.K., ndërkohë që masat disiplinore duhet të jepeshin në mënyrë të përshkallëzuar, përfaqësuesja e Rektorit u shpreh se pasojat e ardhura nga mosveprimi i ankueses ishin të rënda dhe ndodhur në këto kushte ndaj saj ishte marrë masa disiplinore në fjalë.

Znj. D.K. shprehu kundërshtimet e saja në lidhje me sa më sipër, duke theksuar faktin se ajo kishte vepruar sipas urdhërave të Zv/Rektorit, pasi në atë periudhë kohore struktura, ku ajo punonte ka qenë në varësi direkte të tij. Sipas ankueses, praktika e Fakultetit Ekonomik është mbajtur pezull me porosi të Zv/Rektorit, deri në momentin e ardhjes së dokumentacionit të studentëve. Por, në vijim, në kushtet kur nuk u paraqit asnjë dosje, mbi këtë praktikë nuk u veprua kurrë.

Ndërkohë, Znj. Panariti kërkoi shpjegime nga ankuesja lidhur me pretendimet e saj për diskriminim, të parashtruara nga ana e saj. Ankuesja nuk dha argumente bindëse lidhur me këto pretendime.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Znj. D.P. dërgoi shkresën nr. 3825/6, datë 23.10.2018, ku parashtronte kundërshtimet e saj në lidhje me shkresën e dërguar nga Znj. A. B., në mbështetje të pretendimeve të Znj. D.K.
2. Me e-mailin e datës 30.10.2018, Znj. N.M. dërgoi në adresë të Komisionerit disa masa disiplinore të dhëna për disa punonjës të Rektoratit, në vitin 2017.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 115, datë 03.08.2018, së Znj. D.K., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Znj. D.K. punon pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës, që prej vitit 2010. Referuar librezës së punës së ankueses rezulton se pozicioni i fundit i punës që ankuesja ka

mbajtur pranë Rektoratit të UT-së ka qenë “specialist” në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe IT. Mbështetur në kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar, të lidhur në datën 01.05.2018, ndërmjet Znj. D.K. dhe Rektorit të UT-së rezulton se Znj. D.K., me Vendimin nr. 65, datë 02.05.2018, të Rektorit të UT-së emërohet personel ndihmës akademik me karakter administrativ në Rektoratin e Universitetit të Tiranës në detyrën e Specialistes në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe IT-së.

Mbështetur në gjurmën b), pika 3, të Udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017, të Ministrit të Sportit dhe Rinisë *“Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative ne institucionet publike të arsimit të lartë”*, strukturat e kërkimit shkencor janë struktura ndihmës akademike me karakter administrativ, të cilat në referencë të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* janë struktura në varësi të Rektorit të UT-së dhe si rrjedhim emërimet dhe lirimet nga detyra kryhen me vendim të këtij titullari.

Në vijim, me Vendimin nr. 119, datë 02.08.2018, e Rektorit të UT-së *“Për zgjidhjen e menjëherëshme për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës së Znj. D.K.”*, kontrata e punës së lidhur ndërmjet ankuses dhe Rektorit të UT-është zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme. Vendimi i sipërpërmendur i është njoftuar ankuses, nëpërmjet shkresës nr. 3477/4, datë 02.08.2018, së Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Duke iu referuar vendimit nr. 119, datë 02.08.2018, të Rektorit të UT-së, rezulton se ky akt administrativ ka dalë si pasojë e problematikës së konstatuar, në lidhje me shkresën nr. 902, datë 30.05.2018, e Fakultetit të Ekonomisë me lëndë *“Mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturës, kuotat e rialokuara”*. Kjo shkresë ka patur pararendëse shkresën nr. 116, datë 30.01.2017, të të njëjtit Fakultetit, praktikë, e cila rezultoi të ishte mbajtur pezull dhe e pa trajtuar për pothuaj 1 vit e gjysëm nga ana e Znj. Daniela, e cila bënte pjesë në strukturën përkatëse të Rektoratit të UT-së, detyrë funksionale e së cilës ishte trajtimi i çështjeve të sipërpërmendura. Në shkresën nr. 902, datë 30.05.2018, të Fakultetit të Ekonomisë citohet: *“Në vijim të shkresës tonë nr. 116 prot., datë 30/01/2017, me lëndë “Mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturës, kuotat e rialokuara”, ku ju janë dërguar Vendimi i KP-së dhe të dhënat e studentëve të rialokuar, të regjistruar në programin e studimit të ciklit të tretë, doktoratë në FEUT, në formë shkresore dhe elektronike për marrjen e numrit të matrikullimit, ju bëjmë me dije se nuk kanë ardhur ende numrat e matrikullimit për këta studentë. Bashkëlidhur ju dërgojmë edhe një herë të dhënat e studentëve të rialokuar dërguar me anë të shkresës së sipërpërmendur.”*

Një fakt i tillë rezulton edhe nga Memo e datës 11.06.2018, drejtuar Rektorit të UT-së nga Përgjegjësja e Sektorit të Protokoll Arkivës, ku citohet: *“Duke marrë shkas nga shkresa e ardhur Nr. 902 prot, datë 30.05.2018, në të cilën citohet shkresa e risjellë nr. 116, datë 30.01.2017, nga Fakulteti i Ekonomisë, me lëndë: “Mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturës, kuotat e rialokuara” ju informojmë si më poshtë se: Duke dashur ta lidh praktikën, kërkoj në arkivë dhe konstatoj që shkresat nuk ishin dorëzuar nga Sektori i Kërkimit Shkencor, Znj. D.K.. Specialistes Znj. D.K. ju kërkuan praktikat e shkresave, të cilat i dorëzoi në zyrën e Protokoll-Arkivës me datë 03.06.2018.”*

Pas konstatimit të problematikës në fjalë, procedurat e ndjekura nga Rektori i Universitetit të UT-së konsistojnë fillimisht në dërgimin e shkresës nr. 2733/1, datë 19.06.2018, ku kërkohej takim me ankuesen për sqarimin e çështjes në fjalë, fakt që rezultoi edhe nga procesverbali i këtij takimi, datë 20.06.2018. Referuar procesverbalit në fjalë rezultoi se ankuesja ka kërkuar që informacionin mbi këtë çështje ta japë me shkrim. Në vijim, Znj. D.K. ka paraqitur pranë Rektorit të UT-së informacionin e datës 20.06.2018 dhe sqarimet përkatëse, lidhur me çështjen e praktikës së sipërpërmendur të dërguar nga Fakulteti i Ekonomisë mbi marrjen e numrit të matrikullimit për studentët e doktoraturës, kuotat e rialokuara. Bashkëlidhur informacionit të sipërpërmendur gjendeshin edhe 4 (katër) memo të hartuara nga ana e saj në periudha të ndryshme kohore, shkresa nr. 1454, datë 26.10.2016 e Fakultetit të Ekonomisë dhe një fletë me përlllogaritje të kryera nga ana e saj.

Për sa më sipër, nisur nga problematika e paraqitur nga Fakultetit i Ekonomisë, me shkresën nr. 902, datë 30.05.2018, si dhe pas marrjes së informacionit me shkrim dhe të dokumenteve justifikuese, nga ana e Zj. D.K., me qëllim verifikimin e saktë të pretendimeve të saj, Rektori nëpërmjet Urdhërit nr. 10, datë 16.07.2018, urdhëroi ngritjen e grupit të punës për të kryer verifikimet përkatëse. Në bazë të Relacionit *“Mbi verifikimin e disa praktikave të ndjekura nga ish-zyra e kualifikimit shkencor dhe projekteve ne rektoratin e Universitetit të Tiranës”*, të hartuar nga grupi i punës rezultoi si më poshtë:

**Së pari**, Znj. D.K. nuk kishte përcjellë në Fakultetin e Ekonomisë dhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, numrat e matrikullimit të ardhura me shkresën nr. 887, datë 06.05.2018, nga AKP për studentët doktorantë të regjistruar në vitin akademik 2011-2012.

**Së dyti**, në mënyrë të vazhdueshme ankuesja i kishte dhënë Rektorit informacion jo të saktë në lidhje me pajisjen me numra matrikullimi të studentëve doktorantë të Fakultetit të Ekonomisë të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 (memot e saj). Pra, informonte vazhdimisht me memot e saj të vitit 2016

dhe 2017, se numrat e matrikullimit nuk kishin ardhur në UT nga AKP, ndërkohë që këto numra kishin ardhur me shkresën nr. 887, datë 06.05.2015, nga AKP.

*Së treti*, përgjatë kësaj periudhe, ankuesja kishte plotësuar diploma doktorature vetëm me numër regjistri, ndërkohë që nga AKP ishin përcjellë më parë numrat e matrikullimit për studentët përkatës;

*Së katërti*, ankuesja kishte plotësuar diploma doktorature me numër regjistri (të cilat janë shpërndarë) edhe në rastet kur AKP nuk i kishte pajisur studentët me numër matrikullimi, për shkak se kishte konstatuar problematika në dokumentacionin e paraqitur prej tyre, siç ishte rasti i studentes doktorante A.G.

Në vijim, në bazë të shkresës nr. 3477/2, datë 26.07.2018, të Rektorit të UT-së, drejtuar ankuseses, kërkohet takim për të diskutuar në lidhje me kontratën e saj të punës me Rektoratin e UT-së. Ky takim është realizuar në datën 30.07.2018, ku edhe është mbajtur procesverballi përkatës. Më pas, ka dalë Vendimi nr. 119, datë 02.08.2018, i Rektorit të UT-së “Për zgjidhjen e menjëherëshme për shkaqe të justifikuara të kontratës së punës së Znj. D.K.”.

Për sa më sipër, rezulton se zgjidhja e kontratës së punës, së Znj. D.K. me Rektoratin e UT-së, në mënyrë të menjëherëshme, për shkaqe të justifikuara, ka ndodhur si pasojë e konstatimeve të grupit të punës, të ngritur me Urdhër të Rektorit të UT-së dhe jo për shkaqet diskriminuese të pretenduara nga ankuesja.

Mbështetur në aktet e depozituara në cilësinë e provës nga të palët gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 115, datë 03.08.2018, së Znj. D.K., Komisioneri gjykon se në referencë nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesja nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Rektorit të UT-së ndaj ankuseses, nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkaqet e pretenduara nga Znj. D.K..

2. Duke qenë se në seancën dëgjimore të datës 18.10.2018, Znj. D.K. hoqi dorë nga pretendimi për diskriminim, pasi Rektori kishte urdhëruar që ajo të transferohej nga zyra e saj, në një zyrë tjetër, si dhe për shkak të përlllogaritjes gabim të vjetërsisë në punë nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, duke i konsideruar si çështje të zgjidhura, në vijim Komisioneri e ndërpreu procedimin administrativ për këto dy pretendime të ankuseses.

3. Në lidhje me pretendimin për diskriminim të ankueses nga ana e Znj. D.P., për shkak të shoqërimit me Znj. A. B., Komisioneri gjykon se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 115, datë 03.08.2018, nuk rezultoi të kishte prova dhe fakte konkrete për të vërtetuar pretendimet e Znj. D.K..

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesja D.K., nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Znj. D.P., Drejtore e Burimeve Njerëzore, pranë Rektoratit të UT-së.

4. Situata diskriminuese e pretenduar nga ana e ankueses, lidhur me mosdhënien e lejes vjetore, e cila ka ndodhur në vitin 2016 dhe ankuesja ka marrë dijëni për këtë diskriminim në momentin e ndodhjes së tij, mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 4, gërma dh)<sup>5</sup>, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nuk u pranua për shqyrtim nga KMD, pasi kjo situatë ka ndodhur tej afatit ligjor të parashikuar në ligjin e sipërpërmendur<sup>6</sup>.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, në formën e shoqërimit të Znj. D. K. me Znj. A. B., për shkak të gjinisë dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës.

---

<sup>5</sup>Neni 33, pika 4, gërma dh), i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon: “Ankesa nuk pranohet nëse: ...dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”

<sup>6</sup> Fakti i sipërpërmendur rezulton edhe në procesverbalin e takimit, të datës 09.08.2018, me Znj. D.K.. Në këtë takim, ankuesja u vu në dijëni për sa më sipër.

2. Konstatimin e mosdiskriminimit, në formën e shoqërimit të Znj. D.K. me Znj. A. B., për shkak të gjinisë dhe përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Znj. D.P., Drejtore e Burimeve Njerëzore, pranë Rektoratit të UT-së.
3. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të 2 (dy) pretendimeve të ankueses, kundër Rektorit të UT-së dhe Drejtores së Burimeve Njerëzore, pranë UT-së, që kanë lidhje me çështjen e transferimit të Znj. D.K., me urdhër të Rektorit, nga zyra ku punonte në një zyrë tjetër, si dhe mbi çështjen e përlllogaritjes së gabuar të vjetërsisë në punë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Rektoratit të UT-së, pasi ankuesja hoqi dorë nga këto pretendime në seancë dëgjimore dhe i konsideroi çështje të zgjidhura.
4. Mospranimin e pretendimeve për diskriminim të Znj. D.K., të cilat janë jashtë afatit ligjor, të parashikuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

\_\_\_\_\_

**KOMISIONERI**

Fusha- punesim  
Shkak - gjinia dhe përkatësia në një grup të veçantë